



PLANI I VEPRIMIT PËR SHËRBIME SOCIALE E FAMILJARE
- KOMUNA E GJILANIT -

Plani I veprimit për Sherbimet Sociale e familjare

Ky dokument është zhvilluar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij i takon Komunës së Gjilanit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të reflektoj pikëpamjet e Bashkimit Evropian apo Save the Children.

Fjala e kryetarit

Sfidat e qeverisjes lokale gjithëherë janë edhe më komplekse, më të ndjeshme dhe më të kushtueshme. Qeverisja gjithëpërfshirëse sfidohet me ekuilibrin e angazhimit të mençur, profesional e vizionar. Qeverisja, duke pasur qytetarin në pronësi të secilit program është më e vështira, është treguesi më i mirë i një mandati të qeverisjes lokale dhe sjellë në pah vetë çelësin e suksesit të një kryetari bashkë me ekipet e tij.

Në përpjekjet tona të pandalshme, për të kontribuar në zhvillim, në mirëqenie, në rritje, në cilësi e digjitalizim të shërbimeve, në avancimin e komunikimit me akterë të rëndësishëm, me partner, rrjete, komunitete, shoqëri civile e biznese, përmes qytetarit gjilanas, komuna e Gjilanit, me një përkushtim të madh, në kuadër të përgjegjësive të saja, ka arritur që të përfundoj planin e veprimit për shërbimet sociale dhe familjare, si një ndër instrumentet më të rëndësishme që ka kërkuar një angazhim të madh, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me organizata vendore dhe ndërkombetare.

Qëllimi i këtij plani është përmirësimi i ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, duke mundësuar edhe avancimin e funksionimit të shërbimeve profesionale sociale për fëmijë, gra, moshë të shtyra, kategoritë e aftësive të kufizuara dhe familjeve në përgjithësi, si dhe të maksimalizoj mirëqenien familjare dhe vijimësinë shkollore të fëmijëve, stabilitetin dhe shëndetin e adoleshentëve poashtu. Me përkushtimin e madh që nëpërmjet këtij plani të tejkalohen edhe sfidat me të cilat përballemi duke pas në konsideratë gjithëpërfshirjen ku secili qytetarë të ketë çasje në shërbimet që mund të ketë nevojë.

Kabineti i Kryetarit të komunës bashkë me drejtorinë përkatëse, kanë përgjegjësitë primare në implementim të planit komunal të shërbimeve sociale e familjare dhe perspektiven e arritjeve tona në sferën e shërbimeve sociale, përgjithësisht. Ky plan komunal, ka vendosë orientimet strategjike të shtrira në zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së mbrojtjes sociale, avancimin e barazisë gjinore, rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale e familjare dhe gjithëpërfshirjen e personave me nevoja të veçanta e grupeve të cenueshme. Ne jemi të vetëdijshëm që puna me fëmijët dhe familjet është një nga fushat më sfiduese, dhe kërkohet dedikim zotues dhe shkathtësi, por që rezultati përfundimtar i punës sociale është një shpërblim që adresohet tek qytetarët e Komunës së Gjilanit. Punonjësitë social duhet të jenë në gjendje që të punojnë me grupe të ndryshme si tek fëmijët poashtu edhe familjet e tyre; nga foshnjat tek adoleshentët, prindërit e vetëm deri tek familjet me dy prindërit, si dhe me grupe të ndryshme profesionistësh, siç mund të jenë policia, shkolla, spitale, qendra shëndetësore, organizata të ndryshme humanitare etj. Në këtë drejtim, kërkohen trajnime të vazhdueshme sa i përket legjislacionit në fuqi, politikat publike që mbulojnë fushën sociale në mënyrë që qytetarët e Gjilanit të kenë një çasje gjithëpërfshirëse në këto shërbime. Ky plan komunal afatmesëm i shërbimeve sociale synon të kontribuoj në uljen e varfërisë dhe rritjen e gjithëpërfshirjeës sociale, zhvillimin e mekanizmave të financimit lokal dhe infrastrukturës, rritjen e portofolios dhe cilësisë së shërbimeve sociale, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve sociale e familjare dhe përmirësimin e pjesëmarrjes aktive të komuniteteve.

Duke marrë për bazë organizimin dhe funksionimin e Komunës së Gjilanit që përmes Drejtorisë përkatëse dhe resoreve të tjera që mbulojnë fushën sociale, të thellohen edhe më tutje bashkëpunimet me organizata vendore dhe ndërkombetare me qëllim të avancimit të mëtejshëm të ofrimit të shërbimeve sociale. Ne duhet të kemi kapacitetet e nevojshme për tejkalimin e çdo sfide që të ofrojmë secilin shërbim që është i nevojshëm për qytetarët e komunës sonë.

Përmes katër prioriteteve strategjike të vendosura përmes këtij plani komunal të shërbimeve sociale, komuna e Gjilanit shpreh entuziazmin dhe zotimin institucional të saj për rëndësinë e implementimit të këtij plani, për perspektiven zhvillimore të mirëqenies së qytetarëve tanë dhe për modelin qeverisës shembëlltë në nivel vendi dhe më gjerë.

Si përfundim, plani i veprimit për shërbimet sociale dhe familjare avancon ndërmarrjen dhe përgjegjësinë komunal të fokusuar në forcimin e familjeve, rritjen e qasjes në shërbimet sociale, luftimin e dhunës në familje, investimin në arsim dhe mbështetjen e popullatës sonë në moshë duke përmirësuar përgjithësisht mirëqenien. Duke zbatuar këto masa, ne mund të ndërtojmë një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse për mirëqenien e çdo individit. Ju bëj thirrje të gjithëve që të bashkoheni me mua në këtë përpjekje, të avokoni për ndryshim dhe të punoni drejt një të ardhmeje më të ndritur, ku askush nuk do të mbetet pas.

Së bashku, ne mund të krijojmë një shoqëri që lulëzon në parimet e kujdesit, përgjegjësisë, transparencës, të drejtave qytetare dhe solidaritetit.

Ju faleminderit,

Alban Hyseni

(Kryetar i Komunës së Gjilanit)

SHKURTESAT

ABGJ – Agjencia e Barazisë Gjinore
ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës
MFPT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MD - Ministria e Drejtësisë
DSHMS - Drejtoria Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
QPS - Qendra për Punë Sociale
MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MF - Ministria e Financave
DPSF - Departmenti për Politika Sociale dhe të Familjes
DSHSF - Divizioni i Shërbimeve Sociale dhe Familjare
GDP - Gross Domestic Product (Prodhimi i Brendshëm Bruto)
OSHC - Organizatat e Shoqërisë Civile
DKRS - Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
OJQ - Organizata Jo-Qeveritare
GJTHP - Gjykata themelore në Prishtinë
PTHP - Prokuroria Themelore në Prishtinë
KOMF - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë
TdH - Terre des hommes
EULEX - European Union Rule of Law Mission in Kosovo
DRC - Danish Refugee Council
Handikos - Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës
QSHM – Qendra e Shëndetit Mendor
QKMF – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
ZRP – Zyra Rajonale e Punësimit
ZKK – Zyra Kadastrale Komunale
MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
QPR – Qendra e Personel Rekrutimit
DSHMS – Drejtoria e Shërbimeve Publike
OFAP – Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror
APRK – Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
IOM – International Organization for Migration
UNHCR – United Nations High Commissioner for Refugees
CRPK – Civil Right Program Kosova
SOS – Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë
UA – Udhëzim administrativ
SNS – Skema e Ndihmës Sociale

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
PLANI I VEPRIMIT PËR SHËRBIME SOCIALE E FAMILJARE	7
REPUBLICA E KOSOVËS	8
KOMUNA E GJILANIT.....	8
POZITA GJEOGRAFIKE	9
PASQYRA DEMOGRAFIKE.....	10
SHËRBIMET SOCIALE NË KOMUNËN E GJILANIT.....	11
QENDRA PËR PUNË SOCIALE - QPS.....	12
NIVELI QENDROR	15
BAZA LIGJORE E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE	15
LIGJI NR. 02/L-17 PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE – NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJI NR. 04/L-081	15
LIGJI I FAMILJES.....	16
LIGJI Nr. 06/L-084 PER MBROJTJEN E FËMIJËS	16
LIGJI Nr. 03/L-182 PER MBROJTJEN NGA DHUNA NE FAMILJE	16
LIGJI PËR VETËQEVERISJE LOKALE	17
LIGJI PËR FINANCA I PUSHTETIT LOKAL	17
AKTET E TJERA NËNLIGJORE DHE JURIDIKE	18
PLANI MATRICOR PËR SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE	19

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky plan veprimi është përpiluar nga Komuna e Gjilanit me qëllim që të krijojë një komunitet gjithëpërfshirës, duke l'u përkushtuar mirëqenies së banorëve të saj si prioriteti kryesor. Qëllimi i këtij plani është përmirësimi i shërbimeve sociale dhe familjare, duke ofruar mbështetje të nevojshme për familjet, duke adresuar sfidat sociale të ndryshme dhe duke forcuar infrastrukturën e shërbimeve sociale në komunën e Gjilanit.

Komuna e Gjilanit është e përkushtuar të sigurojë një mirëqenie të barabartë për të gjitha kategoritë sociale dhe familjare. Ky plan veprimi është dëshmi që tregon se Komuna e Gjilanit është e fokusuar në zbatimin e veprimeve që përmbysin pabarazinë dhe ndihmojnë në avancimin e mundësive për një jetë më të mirë, të shëndetshme dhe të lumtur. Komuna e Gjilanit ka krijuar një bashkëpunim të fuqishëm, duke u përqendruar në të drejtat dhe nevojat e çdo individi, sidomos fëmijëve, për të ndihmuar në krijimin e një shoqërie të barabartë.

Kujdesi ndaj qytetarëve është prioriteti kryesor ku shërbimet janë lehtësisht të arritshme dhe të përqendruara në nevojat e tyre. Duke transformuar shërbimet synohet një lidhje e vazhdueshme me komunitetin, me qëllim që të gjithë anëtarët e këtij komuniteti, pa dallim, të ndjehen të përfshirë dhe të vlerësuar. Hartimi i Planit Komunal të Veprimit për Shërbimet Sociale në Komunën e Gjilanit është mbështetur nga Save the Children Kosova/o në kuadër të projektit **'Avancimi i Ofritit të Shërbimeve Sociale për Grupet e Cenuesheme në Kosovë, në Përgjigje ndaj COVID-19'** financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Plani i Veprimit për Shërbime Sociale dhe Familjare për Komunën e Gjilanit është i bazuar në katër pika kryesor:

- **Mbështetje për familjet:** Në qendër të këtij plani veprimi është promovimi i familjes si themel i shoqërisë. Komuna e Gjilanit synon të ofrojë mbështetje gjithëpërfshirëse për familjet, duke përfshirë kujdesin ndaj fëmijëve, edukimin e prindërve, këshillimin dhe ndihmën financiare. Qëllimi është të fuqizohen familjet dhe t'ju ofrohen mjetet e nevojshme për të zhvilluar një mjedis edukativ dhe të shëndetshëm, duke e bërë kështu jetën e tyre të suksesshme.
- **Forcimi i infrastrukturës sociale:** Komuna e Gjilanit njeht sfidat sociale që përballen disa individë brenda komunitetit, si varfëria, papunësia, të pastrehët, abuzimi me substancat dhe problemet e shëndetit mendor. Nëpërmjet ndërhyrjeve të synuara dhe përpjekjeve bashkëpunuese, synohet të ofrohen sisteme, burime dhe mundësi efektive mbështetëse për këta individë, duke i ndihmuar të riintegrohen në shoqëri dhe të bëjnë jetë normale.
- **Bashkëpunimi dhe përfshirja:** Komuna e Gjilanit vlerëson rëndësinë e përfshirjes dhe pjesëmarrjes së të gjithë akterëve, duke përfshirë agjencitë qeveritare, organizatat e komunitetit, ofruesit e shërbimeve dhe, më e rëndësishmja, vetë qytetarët. Pra, synohet zhvillimi i një rrjeti shërbimesh, partneritetesh dhe programesh të ndërlidhura që punojnë së bashku për të adresuar nevojat unike të banorëve dhe për të promovuar kohezionin social dhe ndjenjën e përkatësisë.
- **Preventiva ndaj dhunës në familje, barazia gjinore dhe mbrojtja e personave me nevoja të veçanta:** Komuna e Gjilanit ka si qëllim të ofrojë preventivë ndaj dhunës në familje, promovoj barazinë gjinore, të ofroj kujdes dhe mbrojtje për personat me nevoja të veçanta, duke përfshirë fëmijët pa kujdes prindëror, të moshuarit pa kujdes familjar dhe personat me nevoja të veçanta. Për këta individë, synojmë të ofrojmë trajnime profesionale, masa inovative dhe mikro-financim që do të mund të ndihmojnë në zgjidhjen e tyre dhe përfshirjen e tyre në shoqëri.

Në këtë Plan Veprimi për Shërbime Sociale dhe Familjare, Komuna e Gjilanit tregon përkushtimin e saj për të adresuar sfidat sociale dhe për të krijuar një komunitet ku çdo banor ka akses në shërbime të nevojshme për të jetuar një jetë të shëndetshme, të pasur dhe të lumtur. Ky plan veprimi do të realizohet në bashkëpunim me akterët e ndryshëm dhe me pjesëmarrjen e plotë të komunitetit, duke siguruar kështu një përfundim të suksesshëm të qëllimeve dhe strategjive të planifikuara.

PLANI I VEPRIMIT PËR SHËRBIME SOCIALE E FAMILJARE

Komuna e Gjilanit është e përkushtuar të krijojë një komunitet gjithëpërfshirës, ku mirëqenia e banorëve të saj është prioriteti kryesor. Duke e ditur rolin e rëndësishëm që luajnë shërbimet sociale dhe familjare në ndërtimin e shoqërive kontemporare dhe të moderuara, paraqesim këtë Plan Veprimi gjithëpërfshirës për Shërbimet Sociale dhe Familjare.

Ky plan veprimi paraqet një udhërrëfyes strategjik që përshkruan misionin, vizionin, synimet dhe strategjitë e komunës sonë për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Ai shërben si një kornizë për të udhëhequr përpjekjet tona në adresimin e nevojave dhe sfidave të ndryshme me të cilat përballen banorët tanë, duke siguruar që ata të kenë akses në sistemet dhe burimet e nevojshme mbështetëse për të bërë jetë të kënaqshme. Në qendër të këtij plani veprimi është familja si themel i shoqërisë sonë. Kuptohet se familjet e forta dhe kohezive janë thelbësore për mirëqenien individuale dhe zhvillimin e komunitetit. Prandaj, ky plan vendos në theks të veçantë ofrimin e mbështetjes gjithëpërfshirëse për familjet, pa u kufizuar në kujdesin ndaj fëmijëve, edukimin e prindërve, këshillimin dhe ndihmën financiare. Duke fuqizuar familjet me mjetet që u nevojiten për të lulëzuar, synohet krijimi i një mjedisi edukativ ku çdo familje mund të jetojë shëndetshëm e të zhvillohet suksesshëm.

Përveç shërbimeve familjare, ky plan veprimi fokusohet edhe në forcimin e infrastrukturës sonë të shërbimeve sociale. Ne e pranojmë se ka individë brenda komunës sonë që përballen me sfida të ndryshme sociale, si varfëria, papunësia, të pastrehët, abuzimi me substancat dhe problemet e shëndetit mendor. Nëpërmjet ndërhyrjeve të synuara dhe përpjekjeve bashkëpunuese, ne përpiqemi të ofrojmë sisteme, burime dhe mundësi efektive mbështetëse për këta individë që të riintegrohen në shoqëri dhe të bëjnë jetë normale.

Ky plan veprimi mbështetet në bashkëpunimin dhe angazhimin e aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë agjencitë qeveritare, organizatat e komunitetit, ofruesit e shërbimeve dhe më e rëndësishmja, vetë qytetarët. Ne e njohim rëndësinë e përfshirjes dhe pjesëmarrjes në formësimin dhe zbatimin e këtyre nismave, duke siguruar që zëri i të gjithë anëtarëve të komunitetit të dëgjohet dhe nevojat e tyre të plotësohen. Përgjatë këtij plani veprimi, do të gjeni qëllime, strategji dhe korniza konkrete të zbatimit që përvijojnë përkushtimin e bashkisë sonë për forcimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Ne synojmë të krijojmë një rrjet shërbimesh, partneritetesh dhe programesh të ndërlydhura që punojnë së bashku për të adresuar nevojat unike të banorëve tanë, për të promovuar kohezionin social dhe për të nxitur ndjenjën e përkatësisë. Me këtë Plan Veprimi për Shërbime Sociale dhe Familjare, ne jemi të përkushtuar të realizojmë vizionin tonë për një komunë ku çdo banor mund të ketë akses në shërbimet që i nevojiten për të bërë një jetë të shëndetshme, të begatë dhe të përmbushur.

Misioni

Përkushtimi dhe angazhimi për të garantuar mirëqenie të barabartë për çdo kategori sociale dhe familjare në komunitet, përmes promovimit të mundësive për një mirëqenie më të mirë dhe një kulturë të gjithëpërfshirjes dhe bashkëpunimit.

Vizioni

Transformimi i shërbimeve përmes kujdesit ndaj qytetarëve si prioritet kryesor i Komunës së Gjilanit për shërbimet sociale dhe familjare, duke u siguruar që shërbimet tona janë lehtësisht të qasshme dhe të përqëndruara në nevojat e qytetarëve.

REPUBLIKA E KOSOVËS

Kosova përfaqëson një shoqëri me një ekonomi në varësi esenciale nga importi, me një bilanc tregtar negativ e shkallë të lartë papunësie e informaliteti, me një rritje mesatare të GDP prej 3.5 – 4 % gjatë 4 viteve të fundit. Mirëpo, marrë në konsideratë rritjen e popullsisë me një shkallë rritje vjetore prej rreth 2 %, kjo rritje mesatare vjetore e GDP në shkallë vendi për kokë banori mbetet irrelevante.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), popullata e Kosovës në vitin 2021 numëronte rreth 1.773.971 banorë, me një popullatë në moshë pune prej rreth 1.202.982, që pothuajse përfaqëson dy të tretat e popullatës së përgjithshme. Bazuar në faktin që Kosovë është një nga vendet në Evropë me popullatën më të re në moshë (rreth 50 % nën moshën 25-vjeçare), parashikohet që mosha e punës do të rritet në mënyrë rapide, duke krijuar presion të madh ngufatës për një ekonomi në konsolidim e sipër, jo stabile, e karakterizuar me mungesë të madhe të mundësive për punësim dhe fuqi punëtore të aftësuar mirë e të shkathët, si një nga sfidat zhvillimore edhe të sektorit privat poashtu. Kosova ka një ndër shkallët më të larta të papunësisë në Evropë me rreth 30.5%. Hulumtimet e ndërmarrja nga ana e ASK, tregojnë se pjesa më e lartë e shkallës së papunësisë shprehet të rinjtë (moshat 15-24 vjeç), ku rreth 48.4% nga gjinia mashkullore dhe rreth 63.5% e gjinisë femërore nga fuqia punëtore (e aftë për punë) janë të papunë. Faktori gjini është poashtu një indikator shumë më rëndësi që tregon se gjinia femërore janë në një pozitë shumë më të pafavorshme krahasuar me gjininë mashkullore në të gjitha nivelet e shkollimit, pra, edhe me predispozita më të mëdha të mbesin të papunë. Këto janë fakte shqetësuese marrë në konsideratë shkallën e papunësisë dhe nivelet e shkollimit të rinjëve kosovarë.

Raportet vjetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MFPT/MD), (raporti vjetor i vitit 2016) rreth Punës dhe Punësimi tregojnë që minoritetet etnike marrin pjesë me rreth 14.4% në totalin e punëkërkuesve të regjistruar në vend. Poashtu, sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, rreth 60% e popullatës jetën në varfëri në zonat rurale. Ndërsa, shkalla e papunësisë në zonat rurale shkon rreth 40% dhe shumica e fuqisë punëtore nuk ka aftësi e shkathësi tregu pune ose deri në nivel mesatar të tyre. Ngecjet në shkollim është një problem shumë i veçantë dhe i ndjeshëm për të rinjtë veçmas nga zonat rurale. Thënë këto, fuqia punëtore e tregut rural të punës ka ma pak predispozita të ketë qasje në burime të hyrash jo të ndërlidhura me punimin e tokës se sa me të njëjtit nga zonat urbane ose periferike-urbane, pra me një ballafaqim të rritjes së shkallës së përjashtimit socio-ekonomik. Personat me nevoja të veçanta poashtu ballafaqohen me kufizime të dukshme që afektojnë statusin e tyre të punësimi, dhe një përqindje e madhe e tyre janë punëkërkues. Sipas Raportit vjetor për Punë edhe Punësim të MFPT/MD, shkalla e punësimi të personave me nevoja të veçanta është 6,47%, përderisa rreth 43% e tyre kanë treguar interes ose kanë potencial për zhvillim të aftësive të tyre, të marrin pjesë në aftësi profesionale dhe t'i përcjellin mundësitë për punësim. Këto të gjetura, nga raportet vjetore të MFPT/MD sugjerojnë që ka mjaft hapësirë për intervenime specifike, trajnime profesionale, masa inovative e mikro-financimi që do të mund të targetonin kategoritë e personave me nevoja të veçanta.

KOMUNA E GJILANIT

Gjilani është një qytet i vendosur në lindje të Kosovës, me një histori të gjatë dhe të pasur kulturore. Komuna e Gjilanit është njëra nga shtatë qarqet si komuna më të mëdha, e që shtrihet në pjesën jug-lindore të Republikës së Kosovës, rajoni i Anamoravës. Qytetin e Gjilanit e përshkojnë tre lumenjë të vegjël: Mirusha, Banja dhe Stanishori të cilët bashkohen dhe derdhen në Moravë të Binçës. Rajoni i Gjilanit është i pasur me xehe (hekur e leucid) dhe burime minerale (Nasalë, Pidiq, Kmetoc, Uglar, Përlepnicë). Gjilani ka kushte te mira për bujqësi dhe njihet si qytet agro-industrial me klimë të mesme kontinentale.

Komuna e Gjilanit përbëhet prej 392 km², duke përfshirë 42 zona kadastrale. Si rezultat i decentralizimit dhe hyrjes në fuqi të Ligjit për *Vetëqeverisje* Lokale (Nr. 03/L-040) dhe Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave (Nr. 03/L-041), Komuna e reduktuar për 123 km² (12 zona kadastrale), të cilat i janë bashkuar Komunës së Parteshit (3 zona kadastrale) dhe komunës së zgjeruar të Artanës (9 zona kadastrale).

Komuna e Gjilanit përfshin qytetin e Gjilanit dhe 48 fshatra. Sipas ASK, popullsia e vlerësuar në Gjilan për vitin 2021 ishte 73.518 në 42 njësi administrative. Vlen të theksohet se ky numër i popullsisë ka pësuar rënie sistematike që

nga viti 2011. Popullsia e vlerësuar në Gjilan për vitin 2011 ishte 90.178, ku 87.814 janë shqiptarë, 978 turk, 624 serbë, 361 romë, 121 boshnjakë, 15 ashkali, 69 goranë, 1 egjiptian dhe 95 të etnive tjera të papërcaktuara.

Tabela 1: Të dhëna të përgjithshme statistikore

Subjekti	Të dhëna statistikore
Sipërfaqe	392 km ²
Popullsia	90.178
Vendbanime konvencionale	16.973
Fshatra	48

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (2011)

Gjilani shquhet për një diversitet komunitetesh me një komunikim shumë të lartë nder-komunitar. Gjilani është kryesisht i populluar me shqiptarë, komuniteti turk përfaqësohet me 978 banorë, pastaj është komuniteti serb me 624 dhe pastaj radhiten komunitetet tjera, romë, boshnjakë, goranë, ashkali etj.

Në bazë të statistikave të siguruara nga ASK (2022), në raportin për Mirëqenien Sociale thuhet se në Gjilan perfitojne nga skema e ndihmes sociale 747 (muaji janar 2022). Nëse bazohemi në numrin e familjeve që pranojnë ndihma sociale, por edhe numrin e anëtarëve të familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale, atëherë mund të konkludohet se Gjilani është një nga 7 qarqet që me se paku perfiton nga skemat sociale, bazuar në statistikat si në tabela 2.

Tabela2: Numri i familjeve dhe anëtarëve të familjeve që kanë përfituar ndihma sociale

Kategoria (mesatarja e muajve)	Numri
Numri i familjeve që kanë përfituar ndihma sociale	698
Numri i anëtarëve të familjeve që kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale	2,593

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (2022)

POZITA GJEOGRAFIKE

Komuna e Gjilanit gjendet në pjesën juglindore të Kosovës në rajonin e Anamoravës. Shtrirja gjeografike i mundëson lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës por edhe me rajonin, veçanërisht Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në qytetin e Gjilanit shtrihen bregoret: Kodra e Dëshmorëve, Gllama, Dheu i Bardhë, fusha e Malishevës, Zabeli i Sahit Agës dhe Bregu i Thatë, poashtu gjejne shtrirjen edhe tre lumenjë të vegjël: Mirusha, Banja dhe Stanishori dhe që ma pastaj derdhen në Morave në perendim të fshatit Uglar. Ndërtimi i rrugës Gjilan – Lipjan ka shkurtuar dukshëm distancën me Aeroportin Ndërkombëtarë të Prishtinës, ndërlidhjen me autostradat qendrore por edhe me hekurudhat e Kosovës. Gjilani ofron kushte të mira për Bujqësi ku edhe njihet si qytet agro-industrial, mbizotëron klimë e mesme kontinentale. Poashtu në rrethinat e Gjilanit ka pasuri me xehe (hekur e leucid) dhe me burime minerale (Nasalë, Pidiq, Kmetoc, Uglar, Përlepticë).

Territori i kësaj komune kufizohet në juglindje me Preshevën në një distancë prej 33 km dhe Kumanovën (Republika e Maqedonisë së Veriut) 53 km, ndërsa në lindje me Bujanocin në një distancë prej 40 km. Gjilanin e ndajnë 46 kilometra nga Kryeqyteti i Kosovës, ndërsa Kamenica dhe Vitia janë 27 km, përkatësisht 22 km nga Gjilani si dhe Artana me një distancë prej 25 km.

PASQYRA DEMOGRAFIKE

Pjesa më e madhe e banorëve prej 96.68% i takon etnisë shqiptare, gjersa sa i përket përkatësive tjera 0.72% të banorëve janë të përkatësive turke. Ndërsa sa i përket religjionit, pjesa dërmuese e banorëve me 99.36% i takojnë besimit islam ndërsa 0.06% i takojnë besimit katolik.

Tabela 3: Numri i banorëve sipas etnivitetit

	Shqiptar	Serb	Turq	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Goran	Të tjerë
Nr. i banorëve	87814	624	978	121	361	15	1	69	95
% e banorëve	97.37%	0.69%	1.08%	0.13%	0.40%	0.01%	0.001%	0.07%	0.10%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (2011)

Për nga grup moshë, pjesa më e madhe e popullsisë prej 66.71% përbëhet nga grup moshë 15 – 64 vjeç. Ekziston një bilanc gjinor i **baraspeshuar** ku 49.80% të popullsisë janë femra dhe 50.20% e popullsisë janë meshkuj, ndërsa sa i përket grupmoshave, me 46.14% dominon **grupmosha** 0-24 vjeçare, 28.62% i takojnë **grupmoshës** 25-45 vjeçare dhe 19.31% i takojnë grup-moshës mbi 50vjeçare.

Tabela 4: Numri i banorëve sipas grup-moshave

	0-4 vjeç	5-14vjeç	15-19 vjeç	20-64 vjeç	>65 vjeç
Nr. i banorëve	6409	17055	9824	50336	6554
% e banorëve	7.10%	18.91%	10.89%	55.82%	7.27%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (2011)

Sipas te dhenave të siguruar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës të vitit 2011; qyteti i Gjilanit ka 54239 banorë, ndërsa në teresi komuna e Gjilanit ka 90178, me 48 e fshatra dhe qyteti i Gjilanit.

Tabela 5: vendbanimet e qytetit të Gjilanit


Vendbanimet	Tipi (urban/rural)	Banor (nr.)	Vendbanimet	Tipi (urban/rural)	Banor (nr.)
Bilincë	Rural	314	Llovcë	Rural	169
Bresalc	Rural	2823	Malishevë	Rural	3165
Bukovik	Rural	80	Muçibabë	Rural	80
Burincë	Rural	-	Nasalë	Rural	209
Capar	Rural	208	Përlepnicë	Rural	1944
Cërnice	Rural	1963	Pidiq	Rural	342
Çelik	Rural	87	Pograxhë	Rural	1211
Demiraj	Rural	112	Ponesh	Rural	967
Dobërçan	Rural	1659	Selishtë	Rural	179
Dunav	Rural	10	Sllakoc i Epërm	Rural	256
Gadish	Rural	331	Sllakoc i ulët	Rural	64
Goden	Rural	29	Sllubicë	Rural	73
Gumnishtë	Rural	473	Stançiq	Rural	8
Gjilan	Urban	54239	Stublinë	Rural	79
Haxhaj	Rural	206	Shillovë	Rural	547
Inatoc	Rural	30	Shurdhan	Rural	156
Kishnapolë	Rural	235	Terzijaj	Rural	-
Kmetoc	Rural	691	Uglar	Rural	1021
Kravaricë	Rural	264	Veleknicë	Rural	1602
Kurexh	Rural	394	Vërbicë e Kmetocit	Rural	348
Lipovicë	Rural	24	Verbicë e Zhegocit	Rural	584
Livoç i Epërm	Rural	2551	Vrapçiq	Rural	290
Livoç i Ulët	Rural	3497	Zhegër	Rural	3327
Lladovë	Rural	545	Zhegoc	Rural	168
Llashticë	Rural	1624	Gjithsej 40 vendb.	1 Urban; 48 Rurale	90178

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (2011)

SHËRBIMET SOCIALE NË KOMUNËN E GJILANIT


Komuna e Gjilanit në bazë të Statutit dhe Rregullores për Organizimin e Brendshëm ka paraparë 12 drejtori, ku Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale përmes Sektorëve të saj: merret me ofrimin e shërbimeve për mirëqenie sociale për qytetarët e Komunës, ushtron aktivitetet lidhur me kujdesin parësor shëndetësor të qytetarëve, vlerësimin e nevojave lokale, monitorimin rreth përkujdesjes së rasteve sociale, mbrojtjen e fëmijëve të rrezikuar dhe mbikëqyrjen e situatës epidemiologjike në nivel të komunës.. Kjo drejtori ka këtë strukturë organizative:

Diagrami 1: Organogrami i Drejtorisë Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale



Komuna e Gjilanit në mënyrë të vazhdueshme bën përpjekje për avancimin e mirëqenies sociale të qytetarëve të saj. Bazuar në kornizën ekzistuese, si të nivelit qendror ashtu edhe të atij lokal, përgjegjësi dhe detyrave të vet drejtorisë për shëndetësi dhe përkujdesje sociale, orientimet e nivelit komunal shkojnë drejt synimeve sikur në vijim:

Figura 2: Orientimet e nivelit komunal drejt synimeve



Këto synime pritet që të kontribuojnë drejt orientimit të nivelit komunal në avancimin e mirëqenies sociale të qytetarëve përmes formave sikurse në vijim:

Figura 3: Format në avancimin e mirëqenies sociale



QENDRA PËR PUNË SOCIALE - QPS

Institucioni më i rëndësishëm i mirëqenies sociale në nivel lokal e që vepron në kuadër të MFPT/MD është Qendra për Punë Sociale (QPS). QPS-ja themelon organin e kujdestarisë që ka mandat mbrojtjen e fëmijëve dhe rasteve të nevojës sociale. Ndërsa, në kuadër të Kuvendit Komunal rreth çështjeve sociale përkujdeset DSHMS.

Kryesisht QPS merret me:

- Koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në kuadër të komunës;
- Zbatimin e politikave nacionale dhe lokale për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna
- Ofrimin e informacioneve përmes qendrës së informacionit, ku fëmijët dhe familjet në kuadër të komunës, mund të informohen apo të referohen tek shërbimet apo institucionet tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë;
- Përcaktimin e së paku një (1) zyrtari përkatës përgjegjës dhe të specializuar për të koordinuar masat dhe ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijës.


QPS e Gjilanit në kuadër të fushëveprimit që ushtron, kujdes të veçantë i kushton kategorive të mëposhtme shoqërore përmes:

- Përkujdesjes dhe **mbrojtjes** së fëmijëve pa kujdes prindëror,
- Mbrojtjes së fëmijëve dhe të **rinjve** me nevoja të veçanta dhe të atyre në konflikt me ligjin,
- Mbrojtjes sociale të të rriturve me gjendje të nevojës sociale,
- Mbrojtjes së të rriturve me nevoja të veçanta,
- Mbrojtjes së të moshuarve pa kujdes familjar dhe pa mjete për jetesë,
- Punës së kujdestarisë dhe mbrojtjes së familjeve në realizimin e të drejtave juridike,

QPS-ja e Gjilanit përbëhet nga një staf aktual prej 11 zyrtarë, ndërsa në organogram ka të planifikuar 17 dhe organizohet në:

- Shërbimin social profesional
- Skema e ndihmës sociale
- Administrata dhe financat

Diagrami 1: Organogrami i Qendrës për Punë Sociale



Më poshtë gjeni disa nga treguesit kryesor që flasin mbi gjendjen e shërbimeve sociale për Komunën e Gjilanit:

Tabela 6: Treguesit kryesorë të shërbimeve sociale në vitin 2023

Numri i popullsisë	90,178
Numri i personave mbi 60 vjeç e lart	9,359
Numri i personave që marrin pension bazë për të moshuarit në tremujorin e parë të vitit 2023	8,958
Numri i personave për të cilët burim kryesor i jetesës është ndihma sociale	2,076
Numri i familjeve që përfitojnë nga ndihma sociale në tremujorin e parë të vitit 2023	558
Numri i anëtarë të familjes që përfitojnë nga ndihma sociale në tremujorin e parë të vitit 2023	2,076
Numri i familjeve që marrin pension invalidor në tremujorin e parë të vitit 2023	1,135
Numri i familjeve në skemën e ndihmës për fëmijët me nevoja të veçanta në tremujorin e parë të vitit 2023	19
Numri i familjeve që përfitojnë pension për të pamurit e dobësuar në tremujorin e parë të vitit 2023	123
Buxheti vjetor i Qendrës për Punë Sociale	105,100.00
Numri i stafit të punësuar në Qendrën për Punë Sociale	11 (17)
Viti i themelimit të Qendrës për Punë Sociale	1972

Burimi: DSHMS (2023)

QPS-ja ofron shërbime për të gjitha kategoritë e njerëzve në nevojë (të moshuar, persona me nevoja të veçanta duke përfshirë edhe fëmijët, fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët në konflikt me ligjin, të mbijetuarit e dhunës në familje dhe të tjerët). Ndërsa, llojet e shërbimeve të ofruara nga QPS-ja në Gjilan përfshijnë kujdestarinë, strehimin familjar, adoptimin, pajtimin familjar, kujdesin, strehimin në qendra komunitare, strehimin institucional, strehimin për viktimat e dhunës në familje, të trafikimit të qenieve njerëzore dhe krimeve seksuale. Vlen të theksohet se QPS-të ofrojnë edhe këshillime, mbrojtje dhe risocializim për fëmijët në konflikt me ligjin.

Në lidhje me kapacitetin e burimeve njerëzore për të ofruar shërbime, stafi është i trajnuar mirë dhe i përgatitur. Shumica prej tyre kanë përvojë pune në këtë fushë dhe janë të licencuar, gjë që i bën ata në gjendje të ofrojnë shërbime cilësore për klientët e tyre.

QPS në Gjilan përballlet me sfida të mëdha, duke përfshirë mungesën e fondeve, mungesën e subvencioneve për ofruesit e shërbimeve dhe **staf jo të mjaftueshëm, nga 17 pozita të parapara ne organogram aktualisht janë vetëm 11**. Nga ana financiare, mungesa e një buxheti të dedikuar për shërbimet dhe mungesa e burimeve të tjera të të ardhurave kufizojnë kapacitetet e QPS-së për të ofruar shërbime të nevojshme. Në lidhje me burimet njerëzore, QPS-ja Gjilan nuk ka numrin e mjaftueshëm të ofruesve të shërbimeve sociale. Vështirësitë më të mëdha hasen në ofrimin e shërbimeve për të moshuarit, viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët në konflikt me ligjin. Gjithashtu, kapacitetet infrastrukturore nuk janë të pamjaftueshme dhe kjo e vështirëson zbatimin e sesioneve të këshillimit.

QPS ka bashkëpunim me disa Organizata Joqeveritare (OJQ) të nivelit kombëtar. Megjithëse nuk ka memorandume të nënshkruara për partneritet në ofrimin e shërbimeve, partneritetet ekzistuese janë më shumë të fokusuar në ofrimin e mbështetjes për të përfituarit sesa në planifikimin e përbashkët për ofrimin e shërbimeve.

Më poshtë është paraqitur SWOT analiza e QPS-së ku kemi identifikuar përparësitë dhe dobësitë, por edhe mundësitë dhe rreziqet me të cilat ballafaqohen shërbimet sociale dhe QPS Gjilan:

SËOT ANALIZA

(S) Anët e forta	(W) Anët e dobëta
<ul style="list-style-type: none"> • Staf i kualifikuar dhe trajnuar; • Staf me përvojë të gjatë/memorie institucionale; • Potenciali për përkrahjen e grupeve të marginalizuara; • Fleksibilitet në ofrimin e shërbimeve; • Bashkëpunimi nder-institucional 	<ul style="list-style-type: none"> • Mos adaptimi me risitë teknologjike – digjitalizimi; • Mungesë e mjeteve të avancuara për matje dhe vlerësim; • Ndikim i vogël në ndërtimin e politikave; • Varësi nga fondet e jashtme; • Rezistencë për ndryshim; • Kapacitetet e limituara të resurseve humane; • Buxhet i pamjaftueshëm
(O) Mundësitë	(T) Kërcënimet
<ul style="list-style-type: none"> • Integrimi i mjeteve teknologjike; • Bashkëpunimet dhe partneritetet • Fuqizimi dhe angazhimi në komunitet • Trajnimet sistematike të stafit të ofruara nga MFPT/MD por edhe partnere të ndryshëm vendor e nderkombetare • Lehtësime të tjera administrative 	<ul style="list-style-type: none"> • Niveli jo i kënaqshëm i shërbimeve të integruara për grupet e cenuara • Kapacitetet humane dhe materiale të limituara nga sektori i shërbimeve sociale • Niveli jo i kënaqshëm i shërbimeve të balancuara ndaj personave me aftësi të kufizuara, grupeve të cënuara për grupet e cenuara • Mungesa e qendrave strehuese, rehabilituese, rekreative, sociale • Niveli jo i kënaqshëm i digjitalizimit, shërbimeve online

NIVELI QENDROR

Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes në MFPT ka detyrën e zhvillimit dhe zbatimit të politikave dhe strategjive, legjislacionit, monitorimit dhe zbatimit të standardeve në fushën e politikave sociale dhe të familjes. Përveç kësaj, ata janë përgjegjës për adresimin e kërkesave për licensime, administrimin e skemave të beneficioneve dhe zhvillimin e analizave në fushën e politikave sociale dhe të shërbimeve familjare.

Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe të Familjes, ka detyrën për të ruajtur, monitoruar dhe zbatuar standardet profesionale dhe disiplinore në fushën e shërbimeve sociale dhe të familjes, duke përfshirë licensimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve sociale dhe të familjes. Pas decentralizimit në vitin 2009, shërbimet sociale dhe të familjes në përgjithësi ofrohen nga 40 QPS, të cilat operojnë në të gjitha 38 komunat e vendit. Këto institucione vendore kanë përgjegjësi për administrimin e Skemës së Ndihmës Sociale të Kosovës. Një numër i shërbimeve sociale ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile, të njohura si OJQ-të sociale, duke përdorur modele bashkëpunimi për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

Një gamë shtesë shërbimesh sociale dhe familjare mbeten nën përgjegjësinë e nivelit qendror, duke përfshirë:

- shërbimet rezidenciale,
- shërbimet komunitare,
- shërbimet në shtëpi për të përfituarit,
- qendrat e kujdesit ditor për personat e moshuar dhe ata me nevoja të veçanta (për të dy gjinitë),
- si dhe shërbimet për viktime të dhunës familjare.

Gradualisht këto shërbime transferohen në përgjegjësinë e niveleve lokale. Procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare ishte planifikuar të përfundojë në vitin 2015, megjithatë sfidat e ndryshme kanë ngadalësuar procesin dhe transferimin e plotë në nivelin komunal.

Si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal, janë bërë hapa të rëndësishëm në sigurimin e qëndrueshmërisë së ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare përmes krijimit të partneriteteve midis institucioneve qeveritare, OJQ-ve dhe Ndërmarrjeve Sociale.

BAZA LIGJORE E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE

I vetmi opsion që garanton adresimin e problemeve të identifikuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare është adresimi me ndryshime ligjore, meqë shkaku kryesor i problemeve të identifikuara janë dispozitat ligjore që krijojnë efekte në këtë sistem.

Më poshtë paraqesim një pëmbledhje dhe analizë të legjislacionit bazë që rregullon çështjet e shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë.

LIGJI NR. 02/L-17 PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE – NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJI NR. 04/L-081

Ky Ligj ka si qëllim të përcaktojë dhe rregullojë ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat dhe familjet në nevojë në Kosovë. Gjithashtu, ky ligj rregullon shërbimet për fëmijët dhe familjet, duke i kushtuar rëndësi të veçantë interesit më të mirë të fëmijës, si në aspektin e kujdesit direkt dhe punës me ta, ashtu edhe në aspektin e marrjes së vendimeve për fëmijën. Për shërbimet sociale dhe familjare ky ligj rregullon edhe shërbimet për të rriturit. Më bashkëpunim me familjet, komunitetet, organizatat joqeveritare dhe organet e tjera të parashikuara me ligj, komuna ofron kujdes social, këshillim dhe, në raste të veçanta, ndihmë materiale për njerëzit që kanë nevojë për shërbime sociale dhe jetojnë në territorin e saj.

Mbrojtja e të rriturve në rrezik me këtë ligj zbatohet kur ka dëshmi që një i rritur nuk është në gjendje të kujdeset për veten për shkak të aftësive të kufizuara mendore ose është i braktisur, i shfrytëzuar ose i abuzuar nga të tjerët për shkak të moshës, dobësisë ose aftësive të kufizuara fizike dhe mendore.

LIGJI I FAMILJES

Ky Ligj rregullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin (birësim), kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare. Gjithashtu, ligji parasheh kujdestarinë për fëmijët e mitur që të gëzojnë mbrojtje të veçantë nga institucionet publike, për moshat madhore që të sigurojnë jetë të pavarur dhe mbrojtje të personalitetit të tyre, dhe personave nën përkujdesje për sigurimin e të drejtave pasurore.

LIGJI Nr. 06/L-084 PER MBROJTJEN E FËMIJËS

Ky ligj ka për qëllim:

- mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;
- të garantojë dhe sigurojë përgjegjësitë e prindërve, familjes, organit të kujdestarisë, shoqërisë dhe të shtetit në kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës bazuar në interesin më të mirë të fëmijës;
- përcaktimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, mekanizmat efikase dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e lokal, si dhe kompetencat e tyre për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;
- garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesjen efektive për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik;
- marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin gradual të aftësive të fëmijës, bazuar në interesin më të mirë të tij;
- marrjen e masave për të siguruar jetesën, mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës;
- sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve në nivel qendror dhe lokal, si dhe organizatave për mbrojtjen e fëmijës;
- përcaktimin e mekanizmave efektivë, funksionimin e institucioneve mandatore dhe marrjen e masave konkrete për parandalim, reagim dhe mbrojtje të fëmijës;
- ngritjen e sistemit të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e nrglizhimit.

LIGJI Nr. 03/L-182 PER MBROJTJEN NGA DHUNA NE FAMILJE

Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktimat e dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me nevojë. Poashtu edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.

LIGJI PËR VETËQEVERISJE LOKALE

